



# Rrjeti i Grave të Kosovës

*Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë*

12 shkurt 2026

I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Kurti,

Po ju drejtohem në emër të Rrjetit të Grave të Kosovës, një rrjet multietnik prej 103 organizatash për të drejtat e grave në mbarë Kosovën, që përfaqëson interesat e më shumë se 10,000 grave të ndryshme dhe që vetëm gjatë vitit 2025 ka avancuar të drejtat e mbi 150,000 përfituesve.

Ju përgëzojmë për formimin e Qeverisë së re të Republikës së Kosovës. Pas një procesi të zgjatur, mirëpresim mundësinë për të ecur përpara me reformat e shumëpritura, përfshirë ato që ndërlidhen me procesin e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian (BE).

Në të njëjtën kohë, dëshirojmë të shprehim shqetësimin tonë lidhur me përqindjen e ulët të grave të emëruara si ministre në Qeverinë e re. Ligji për Barazi Gjinore parasheh përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrje (50%). Sigurimi i përfaqësimit të balancuar nuk është vetëm obligim ligjor, por edhe thelbësor për qeverisje demokratike dhe për avancimin e barazisë gjinore substanciale në Kosovë.

Teksa Kosova avancon me reformat thelbësore, ne theksojmë rëndësinë e integritetit sistematik të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në të gjitha fushat e politikave publike. Konkretisht, i bëjmë thirrje Qeverisë që të prioritetizojë me urgjencë ndryshimet kyçe ligjore në vijim, si të domosdoshme për garantimin e përmbushjes së obligimeve kushtetuese dhe ligjore të Kosovës për avancimin e barazisë gjinore:

1. **Të miratohet një Ligj i ri i Punës** në përputhje me Direktivën e BE-së për Balancin punë-jetë, duke siguruar të drejta të barabarta për gratë dhe burrat për pushimin e lehonisë, atësisë, prindëror dhe të kujdesit. [Dëshmitë](#) e shumta të mbledhura nga RrGK, ndër të tjera, kanë treguar se ligji aktual po kontribuon në diskriminimin e grave gjatë punësimit dhe është ndër faktorët kryesorë që po minojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Ky ligj duhet të ndryshohet me urgjencë, në konsultim me ne, me asociacionet e bizneseve dhe organizatat për të drejtat e punëtorëve, përmes një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës.
2. **Të përcaktohen tregues të qartë për matjen e progresit drejt barazisë gjinore në kuadër të Instrumentit për Reformë dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor: Agjenda e Reformave e Kosovës**, duke u bazuar në propozimet e Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ) dhe në konsultim me organizatat për të drejtat e grave. Këto reforma duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme gjinore, në mënyrë që të sigurohet se ato u sjellin përfitime grave dhe burrave të ndryshëm.
3. **Të institucionalizohet buxhetimi i përgjegjshëm gjinor** në kuadër të Ligjit të ri për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe

Ligjit për Prokurimin Publik, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore. Integrimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha reformat e financave publike mund të sigurojë që ai të zbatohet në mënyrë të duhur nga zyrtarët financiarë në të gjitha organizatat buxhetore. Reformat duhet të jenë në përputhje me [Udhëzimet](#) e Kornizës Gjinore të Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësisë Financiare (PEFA) dhe me [Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 5.c.1](#). Kjo përfshin detyrimin që të gjitha organizatat buxhetore të publikojnë në mënyrë transparente Deklaratat e Buxhetit Gjinor dhe/ose anekse për buxhetimin gjinor.

4. **Të krijohet një linjë buxhetore** brenda Agjencisë për Barazi Gjinore **për mbështetjen e grupeve të ndryshme për të drejtat e grave**, në përputhje me zotimet e Kosovës ndaj Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, me qëllim të adresimit të [krizës aktuale të financimit](#) që rrezikon punën e tyre të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve, rritjen e vetëdijes, hulumtimin, avokimin dhe këshillimin, si dhe në mbështetjen e qeverisë dhe palëve të tjera të interesit. Financimi duhet të dizajnohet në konsultim të ngushtë me organizatat e ndryshme për të drejtat e grave, për të siguruar që ai të jetë transparent, i drejtë dhe i bazuar në nevoja.
5. **Të investohet në kujdes:** Ndërsa themelimi i çerdheve të reja është prioritet i Qeverisë, siç theksohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, Agjendën Evropiane të Reformave, Planin e Rritjes dhe në fjalimin tuaj të mbrëmshëm, hapja e këtyre qendrave ka ecur shumë ngadalë. Ofrimi më i qasshëm dhe më i përballueshëm i kujdesit për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara në gjithë Kosovën është thelbësore për t'u mundësuar grave hyrjen në tregun e punës. [Hulumtimi](#) i RrGK-së tregon se kjo mund të krijojë më shumë se 9,900 vende të reja pune, veçanërisht për gratë, duke transformuar punën e papaguar në punë të paguar.

Megjithëse këto janë rekomandimet tona kyçe, shpresojmë që Qeveria të vazhdojë të shfrytëzojë hulumtimet tona, rekomandimet e bazuara në dëshmi dhe ekspertizën tonë për të informuar ndryshimet e tjera të ardhshme në ligje, politika dhe programe. I bëjmë thirrje Qeverisë, në frymën e demokracisë gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, që të sigurojë përfshirjen e grupeve për të drejtat e grave në të gjitha grupet punuese qeveritare, në mënyrë që të kontribuojmë me ekspertizën tonë në mbështetje të këtyre reformave të rëndësishme.

Ne mirëpresim një bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë e re dhe të gjithë ministrat për mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave të grave në Kosovë.

Me respekt,

Igballe Rogova  
Drejtore Ekzekutive  
Rrjeti i Grave të Kosovës